



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:109940
Datë: 13.09.2022
Numri i dokumentit: 03418807

PPP.nr.42/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me zyrtaren ligjore Albulena Latifi, në çështjen juridike përmbare të kreditorit N. K., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B. K., avokat në Prizren, kundër debitorit Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim, për kompensimin e shujtës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të datës 29.01.2021, të paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit P.nr.21/2021 të datës 12.01.2021, i lejuar nga Zyra Përmbaremit e Përmbaremit Enis Hoxha nga Prizreni, jashtë seancës, me datë 13.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET** i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbaremit, P.nr.21/2021 të datës 12.01.2021, i lejuar nga Zyra Përmbaremit e Përmbaremit Privat, Enis Hoxha, në Prizren.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e përmbaremit në këtë çështje juridike të përmbaremit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbaremit, të gjitha shpenzimet e përmbaremit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbaremit.

A r s y e t i m

Zyra Përmbaremit e Përmbaremit Privat, Enis Hoxha, në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N. K., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. K., avokat në Prizren, ka caktuar urdhrin për përmbaremit P.nr.21/2021, datë 12.01.2021 në bazë të dokumentit përmbaremit - Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.1742/2020, datë 29.12.2020, i cili është dokument përmbaremit dhe paraqet bazë për lejimin e përmbaremit sipas nenit 21 dhe 22 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbaremit (tutje LPP).

Kundër urdhrit për lejimin e përmbaremit, brenda afatit ligjor, me datë 29.01.2021, prapësim ka paraqitur debitori Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim, në të cilin ka parashtruar se procedura përmbaremit është iniciuar në kundërshtim me nenin 71 paragrafi 1, pika 1, nënpika 1.1, 1.2 dhe 1.4 të LPP-së, për shkak se dokumentit mbi të cilin është bazuar propozimi i mungojnë veti të dokumentit përmbaremit, dokumenti është i papërshtatshëm për përmbaremit, ngase është nxjerr nga organi që tejkaloar autorizimet dhe kompetencat ligjore. Ka

shtuar se Vendimi i Inspektoratit të Punës me seli në Gjakovë, në të cilin është bazuar propozimi për përmbarrim dhe urdhri përmbarrimor, është në kundërshtim me nenin 24 par. 3 të LPP-së, ngase kjo dispozitë ka përcaktuar se “Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”. Në rastin konkret, organi administrativ, Inspektorati i Punës, me vendim Nr.1742/2020 të datës 29.12.2020, ka shkelur kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Inspektoratin e Punës, Ligjin e Punës dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë, si dhe me këtë është futur në kompetencat e domenit gjyqësor, pasi që kemi të bëjmë me raport civil-juridik nga kontesti i punës, bazuar në nenin 79 të Ligjit të Punës, si dhe të nenit 24 par. 4 të Ligjit për Zyrtarët Publikë. Me propozim për gjykatën që ta aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa propozimi për përmbarrim dhe urdhri për përmbarrim P.nr.21/2021 i datës 12.01.2021, të anulohen si të kundërligjshëm.

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, brenda afatit ligjor, me datë 19.04.2021, ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, në të cilin ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, ngase Përmbarruesi Privat me rastin e lejimit të urdhrin për përmbarrim është mbështetur në vendimin Nr.1742/2020, datë 29.12.2020. Debitori është thirrur në çështjen se vendimi i plotfuqishëm i Inspektoratit të Punës është i paligjshëm, për arsye se e ka nxjerrë organi jokompetent, kjo nuk qëndron për faktin se gjykata përmbarrimore nuk mund të lëshohet në atë se a është kompetent inspektorati për ta nxjerr një vendim të tillë apo jo, kjo është e rregulluar me dispozitat ligjore konkretisht me nenin 22 par. 1 pika 1.2 të nenit 23 nënpar. 3 dhe nenit 27 të LPP-së. Me propozim për gjykatën që të refuzohet i pathemeltë prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, urdhrin përmbarrimor dhe prapësimin të paraqitur nga debitori, si dhe vlerësimin të përgjigjes në prapësim, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se caktimi i përmbarrimit është bërë duke u bazuar në Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.1742/2020, datë 29.12.2020, me të cilin vendim është detyruar që debitori t’ia paguajë kreditorit borxhin në shumë prej 485,57 € në emër të kompensimit për ushqim për 242 ditë pune.

Gjykata ka vlerësuar Vendimin e Inspektoratit të Punës, Nr.1742/2020, datë 29.12.2020, (bazuar në nenin 6 par. 4 të Ligjit Nr.2002/9 dhe 03/L017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, *Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit*), në bazë të të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe vlerëson se ky vendim i plotëson kushtet për t’u paraqitur si dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 par. 1 pika 1.1, 23, 25 dhe 27 të LPP-së, për të qenë i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit Komuna e Rahovecit - Drejtoria për Arsim, lidhur me atë se dokumenti në bazë të të cilit është lejuar përmbarrimi nuk i përmban elementet e kërkuara sipas nenit 27 të LPP-së, mirëpo ky pretendim ishte i pabazuar, ngase vendimi administrativ në fjalë, është i formës së prerë në procedurën administrative, si dhe si i tillë është bërë i përmbarrueshëm edhe në procedurën e përmbarrimit, si dhe në dispozitivin e këtij aktvendimi ceket shuma gjegjëse që duhet t’i kompensohet palës kreditore derisa gjykata në procedurën e përmbarrimit, nuk mund ta shqyrtojë ligjshmërinë e një vendimi administrativ pasi që kjo mund të bëhet në procedurën gjegjëse administrativo – gjyqësore e për më tepër kur dihet se procedura e përmbarrimit, është procedurë e cila bazohet në parimin e rigorozitetit formal, kurse për çështjen e kompensimit për ushqim për të punësuarit në sistemin e arsimit dhe kush e bënë kompensimin e tillë nga organi kompetent i arsimit, bëhet fjalë në nenin 90.5 të Ligjit të Punës, Nr.03/L – 212 , të dt. 01.10.2010, derisa për kushtet ligjore për t’i dhënë kompensimin

për ushqim, bëhet fjalë në nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Arsimit, të datës 18.04.2017. Andaj, gjykata erdhi në përfundim se i njëjti i përmban të gjitha elementet e kërkuara me dispozitën e sipërcituar, ngase sipas nenit 27 të LPP-së, parashihet se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, e që sipas vlerësimit të gjykatës ky vendim i përmban të gjitha elementet e kërkuara.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me kompetencën e Inspektoratit të Punës për të vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së tij, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në bazë të të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Përfundimisht, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e debitorit lidhur me mundësinë e inicimit të konfliktit administrativ ndaj vendimit objekt përmbartimi, mirëpo edhe ky pretendim ishte pa mbështetje ligjore, ngase me nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, parashihet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*, andaj mbi këtë bazë edhe ky pretendim ishte i pabazuar.

Andaj, pas vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e meqenëse debitori nuk ka ofruar prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij, siç është paraparë me nenin 61 e lidhur me nenin 69 par. 4 të LPP-së, dhe nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbartuesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbartimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par. 1, pika 1 deri në pikën 12 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (Ligji Nr.04/L-139), të Republikës së Kosovës, kjo gjykatë vendosi që prapësimin e debitorit ta refuzojë në tërësi të pabazuar.

Vendimin për shpenzimet e përmbartimit e që secila palë t'i bartë shpenzimet e përmbartimit në këtë çështje juridike të përmbartimit, kjo gjykatë e mori në kuptim të nenit 13 të LPP-së lidhur me nenin 450 të LPK-së pasi që secila palë duhet t'i bartë paraprakisht harxhimet të cilat i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta, por se ajo palë që e humb procesin përmbartimor, do t'i bartë të gjitha shpenzimet e përmbartimit.

Për këto shkaqe dhe arsye sipas dispozitës së nenit 73 par. 3 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke refuzuar prapësimin e ushtruar ndaj urdhrorit për përmbartim P.nr.21/2021 të datës 12.01.2021.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
PPP.nr.42/2021, datë 13.09.2022

Zyrtarja ligjore
Albulena Latifi

Gj y q t a r i
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.